



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI  
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë më 15.11.2018  
Dokument parlamentar

**R A P O R T**

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2019”**

*(shqyrtimi në parim)*

**Drejtuar :** Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Bazuar në nenet 79 pika 2 dhe 80 të Rregullores së Kuvendit, në datat 6, 7,8 ,13 dhe 14 nëntor 2018, Komisioni parlamentar për Sigurinë Kombëtare, shqyrtoi në parim projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2019”, për institucionet që ky komision ka në fushën e tij të përgjegjësisë si:

1. Ministrinë e Mbrojtjes;
2. Ministrinë e Brendshme;
3. Shërbimin Informativ Shtetëror;
4. Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve;
5. Gardën e Republikës;
6. Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit ;
7. Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile.

Në mbledhjet e komisionit morën pjesë Ministrija e Mbrojtjes, Zëvendësministri i Brendshëm, Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Drejtori i Përgjithshëm i Emergjencave Civile, kreu i Gardës së Republikës, drejtues të tjerë të këyre institucioneve si dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilët bënë prezantimin në parim të projektbuxhetit për vitin 2019 për institucionet e tyre, problematikat, menaxhimin e buxhetit të vitit 2018 dhe pritshmëritë dhe objektivat që do të arrihen me anë të projektbuxhetit 2019.

**Projektbuxheti 2019** mbështet konsolidimin e mëtejshëm të reformave të ndërmarra në vitet e fundit që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritit në Bashkimin Europian.

Projektbuxheti 2019 do të ketë më shumë burime në dispozicion si rezultat i politikave fiskale të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe uljen e informalitetit, e në të njëjtën kohë ai do të synojë nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Është e rëndësishme të theksohet se projektbuxheti 2019 garanton

vazhdimin e mbështetjes financiare për zbatimin e reformave të tilla si reforma në drejtësi, reforma në administratën publike, reforma e menaxhimit të financave publike dhe reforma administrative-territoriale.

**Komisioni për Sigurinë Kombëtare**, gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në parim, u fokusua në aspektet e buxhetit të cilat trajtojnë elementet financiare që lidhen me rendin publik dhe sigurinë kombëtare.

Komisioni analizoi me vëmendje buxhetin e parashikuar për institucionet të cilat janë përgjegjëse për çështjet e sigurisë dhe rendit publik, institucioneve që kontribuojnë në këto dy komponentë, si Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Garda e Republikës, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit dhe Drejtoria e Përgjithshme të Emergjencave Civile .

Anëtarët e Komisionit për Sigurinë Kombëtare gjatë diskutimit në parim i drejtuan pyetje të shumta Ministres së Mbrojtjes, zv/Ministrit të Brendshëm, kreut të SHISH dhe institucioneve të tjera të thirrura për këtë qëllim, mbi prioritetet që këto institucione duan të arrijnë me anë të këtij projekt-buxheti si dhe nëse buxheti i parashikuar për to plotëson nevojat për ushtrimin normal të funksioneve dhe detyrave të tyre.

**Projektbuxheti i vitit 2019 i parashikuar për institucionet e mësipërme, përmbledhtas, paraqitet si më poshtë:**

## **MINISTRIA E BRENDSHME**

Buxheti, i propozuar për vitin 2019, për Ministrinë e Brendshme është 20,925,335 lekë.

Tre janë shtyllat kryesore që synohet të jetësohen gjatë vitit buxhetor 2019:

1.Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, garantimi i sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, të cilat janë dhe prioritete për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, e cila do të ketë si togfjalësh kyç në veprimtarinë e saj, ‘kontrollin e territorit’ dhe ‘policimin në komunitet’, të realizuara në praktikë përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor, në funksion të një kontrolli më efektiv të tij dhe transformim rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit.

2.Sigurimi i rendit publik, pronës publike e private, rritja e parametrave të sigurisë rrugore, krijimi i një mjedisi të sigurt për komunitetin, nëpërmjet shërbimeve profesionale në kohë dhe me cilësi dhe policimit me standardet me të larta të performancës.

3.Përmirësimi i vazhdueshëm i Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standardet europiane në fushën e sigurisë

## **MINISTRIA E MBROJTJES**

Duke e krahasuar me vitin 2018, buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes ka një rritje sinjifikative, ku nga 19,797,838 lekë në vitin 2018, për vitin 2019 janë parashikuar 21,002,417 lekë, pra paraqitet si buxheti më i madh i parashikuar ndonjëherë që prej anëtarësimit të vendit në NATO, me një rritje prej 6%.

Nëpërmjet Buxhetit të parashikuar për vitin 2019, Ministria e Mbrojtjes synon të arrijë këto objektiva:

1.Modernizimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA duke:

- zhvilluar kapacitetet e FA në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit;
- vijuar pajisjen e Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët në NATO;
- zgjeruar investimet në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake;
- modernizuar pajisjet dhe sistemet kompjuterike.

2. Vijimin e pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s duke rritur nivelin e angazhimit të FA, në operacionet e Aleancës dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndërmarrë.

3.Zhvillimin dhe mbajtja në gatishmëri të kapaciteteve të FA për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave si dhe kapacitetet për përballimin e Emergjencave Civile, dhënien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-se dhe BE-së.

4. Lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura.

❖ Nga dëgjesat e kryera si më sipër, Komisioni vlerëson se buxheti për dy ministrinë përkatëse, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Mbrojtjes është i kënaqshëm dhe krahasuar me vitet e kaluara, buxhetet e të dyjave këtyre institucioneve qendrore kanë ardhur në rritje.

❖ Komisioni gjykon se buxheti i akorduar për Shërbimin Informativ Shtetëror, Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Gardën e Republikës brenda mundësive financiare dhe sipas përparësisë duhet të rivlerësohen duke marrë në shqyrtim disa pika të vecanta.

Për këtë arsye, Komisioni për Sigurinë Kombëtare vendosi t'i kërkojë Komisionit të Ekonomisë, të ketë në konsideratë një rritje në zërin e investimeve dhe shpenzimeve operative për këto institucione, kërkesë kjo e cila do të paraqitet edhe gjatë shqyrtimit të këtij projekt/buxheti nen për nen.

Kërkesat për rritje fondesh konsistojnë në ;

### **Shërbimi Informativ Shtetëror**

Buxheti i vitit 2019 për SHISH, në krahasim me vitet e mëparshme vlerësohet pozitiv, një buxhet i cili mbështet kryerjen e detyrave kryesore për këtë shërbim dhe rolin e tij për sigurinë kombëtare.

Rritja e buxhetit në shumën 1,575,000 lekë, tregon qartë synimin e Qeverisë për forcimin dhe modernizimin e këtij shërbimi si nevojë për t'iu përgjigjur sfidave të rëndësishme në çështjet e sigurisë.

Komisioni mbështet kërkesat e këtij shërbimi për një shtesë në organikë.

Kjo rritje nuk ka kosto financiare shtesë në totalin e buxhetit, pasi bëhet fjalë për shërbimin e sigurisë fizike e cili deri më sot është realizuar nga të tretë dhe me urdhrin e Kryeministrit nr.160, datë 29.10.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën dhe organikën e Shërbimit Informativ të Shtetit” është përfshirë në strukturën e brendshme të SHISH.

➔Kërkojmë po ashtu të sjellim në vëmendjen tuaj, nevojën për shërbimin e mirëmbajtjes së një sistemi të klasifikuar të dhënash e që i shërben kryesisht dy institucioneve, Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Sistemi në fjalë është investim i huaj, shumë i rëndësishëm për sigurinë, prandaj duhet të zgjidhet akomodimi i shumës për mirëmbajtjen e tij, në kushtet kur sistemi nuk mund dhe nuk duhet të dështojë.

Në vitin 2019, Agjencia Shqiptare e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes do të marrë drejtimin e Komitetit të Inteligjencës së NATO-s dhe vetëkuptohet që performanca e vendit tonë në këtë drejtim duhet të rritet edhe nëpërmjet detyrimit për të siguruar mirëfunksionimin e një sistemi të tillë.

### **Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile**

Buxheti i parashikuar për këtë Drejtori për vitin 2019 rezulton të jetë në shumën 295,000 lekë.

Komisioni mendon se ky buxhet duhet të rikonsiderohet, pasi ka ende nevoja për rritje në zërin e investimeve për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore.

Rishikimi i këtij zëri do të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e cenueshmërisë së jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga emergjencat civile dhe në ofrimin e një mbrojtjeje civile më të përshtatshme .

Rritja e buxhetit për Emergjencat Civile mundëson funksionimin normal dhe ofron garanci se masat parandaluese dhe mbrojtëse për përballimin në kohë të situatave emergjente.

Gjatë diskutimeve në komision, u konstatua se kjo drejtori tanimë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mbrojtjes, mbart një borxh prej 700,000 lekë nga vitet e kaluara, nga të cilat janë shlyer vetëm 160,000 lekë.

Nisur nga ky fakt, komisioni sugjeron një rritje në zërin “investime” për të shlyer të paktën deri në 50 % të borxhit të mbartur.

### **Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit**

Referuar buxhetit të planifikuar për këtë drejtori, buxhetimi përse i përket mallrave dhe shërbimeve është në nivele të kënaqshme por duke qënë se kërkesat janë gjithmonë në rritje sa i takon një menaxhimi më të mirë dhe të sigurtë të kufijve dhe brenda standarteve shengen të BE-së, komisioni sugjeron që kërkesa e Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit për integrimin e sistemit të radarëve për mbikqyrjen e hapësirës detare, të shihet me prioritet duke integruar në një sistem të vetëm ose në një administrim të vetëm si radarët e Policisë së Shtetit dhe ato që ka QNOD, ku përfitues të produktit janë dhe institucione të tjera qendrore, me një fond buxhetor prej 405 milion lekë .

### **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**

Referuar buxhetit të planifikuar për vitin 2019 për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve i cili është **5,853,174 lekë**, rezulton se sipas kërkesave të këtij institucioni fondet janë të pamjaftueshme, ndaj komisioni sugjeron të merren në konsideratë kërkesat si më poshtë:

- ❖ Shtesë prej 120 punonjësish, civilë dhe ushtarakë, për vënien në efikasitet të godinës së re të I EVP 313 “Jordan Misja”, investim i cili përfundon në fund të vitit 2018. Për vënien në funksionim të këtij institucioni të ri i cili do të lehtësojë ndjeshëm të gjithë mbipopullimin në paraburgime, do të nevojitet fondi shtesë prej **36,000 mijë lekë**.
- ❖ Njehësimin e pagave të mjekëve të sistemit të burgjeve me ato të mjekëve të sistemit të përgjithëm shëndetësor, në kushtet kur sistemi mjek infermierë në burgje po paraqet gjithnjë e më shumë mungesa për shkak të pagave të ulëta. Fondi shtesë që nevojitet është **38,400 mijë lekë**.

Rritja e buxhetit për Sistemin e Burgjeve mundëson funksionimin normal sipas standardeve europiane dhe ofron garanci se siguria në këtë sistem nuk cenohet, përkundrazi synohet të rritet dhe përmirësohet.

### **Garda e Republikës**

Buxheti i parashikuar për Gardën e Republikës për vitin 2019 parashikohet të jetë **1,570,769 lekë**. Gjatë prezantimit, nga komandanti i Gardës z.Sako, u parashtrua shqetësimi në lidhje me pagat, ku Garda e Republikës vazhdon të jetë strukturë me paga të ulëta.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, sugjeron që punonjësi i Gardës, për shkak të përgjegjësisë, vështirësisë dhe rrezikshmërisë së lartë në detyrë, të ketë përparësi në trajtimin financiar dhe ushqimor.

Sa i takon trajtimi ushqimor, është e rëndësishme të theksojmë se ky trajtim që prej vitit 2013, me një vendim të Qeverisë Berisha u është hequr punonjësve të Gardës. Kërkesa që Garda e Republikës ngriti para Komisioni të Sigurisë dhe të cilën ky komision e gjen me vend ta mbështesë, është që trajtimi ushqimor të përfshihet brenda tavaneve buxhetore të këtij institucioni.

Gjithashtu sugjerohet mbështetja me fondet e nevojshme për realizimin e investimeve në infrastrukturë për financimin e projekteve si : Rikonstruksion i plotë i ndërtesave dhe ambienteve të jashtme e të brendshme në Qendrën e Formimit dhe Kualifikimit Profesional, në Mullet, me vlerë projekti 250,000,000 lekë si dhe sistemim dhe asfaltim sheshi, rrugëve lidhëse dhe parkim mjjetesh, me vlerë 10,000,000 lekë.

**Sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, në përfundim të diskutimeve, me shumicë votash, vendosi të miratojë në parim pr/ligjin për buxhetin e vitit 2019 me sugjerimet përkatëse dhe dërgimin e këtij raporti Komisionit për Ekonominë dhe Financat.**

Relator

**Pjerin NDREU**  
**Xhemal QEFALIA**  
**Sadi VORPSI**

Kryetar

**Ermonela (Felaj) VALIKAJ**

**KUVENDI  
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë, më 20.11.2018  
Dokument parlamentar.

**R A P O R T**

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2019”**

*(shqyrtimi në nen për nen dhe në tërësi)*

**Drejtuar: Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat  
Seancës Plenare**

Bazuar në nenin 32-38 dhe 80 të Rregullores së Kuvendit, në datën 19.11.2018 Komisioni për Sigurinë Kombëtare shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2018”, për institucionet që ky komision ka në fushën e tij të përgjegjësisë si:

8. Ministrinë e Mbrojtjes;
9. Ministrinë e Brendshme;
10. Shërbimin Informativ Shtetëror;
11. Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve;
12. Gardën e Republikës;
13. Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit ;
14. Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile.
- 15.

Të ftuar për të marrë pjesë në diskutim dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësuesit e institucioneve përkatëse dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Pasi dëgjoji mendimin dhe vërejtjet e përfaqësuesve të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit dhe Gardës së Republikës si dhe pas diskutimeve të anëtarëve të tij, **Komisioni për Sigurinë Kombëtare**, vendosi me shumicë votash ta miratojë nen për nen dhe në tërësi pr/ligjin për Buxhetin e vitit 2019 dhe t’ia përcjell komisionit përgjegjës dhe seancës plenare me vërejtjet dhe sugjerimet si vijon.

**I. Për Ministrinë e Mbrojtjes:**

Komisioni dhe Ministria e Mbrojtjes ndajnë të njëjtin mendim se buxheti për vitin 2019 i parashikuar për këtë ministri është buxheti më i madh i akorduar ndonjëherë, me një rritje prej 6% dhe përmbush detyrimet kushtetuese e ligjore për FA-të, modernizimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA, nevojat operationale për përfaqësimin dhe

pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet e NATO-s apo misione të tjera ndërkombëtare.

## **II. Për Ministrinë e Brendshme**

Ashtu si buxheti i parashikuar për Ministrinë e Mbrojtjes, edhe buxheti i parashikuar për Ministrinë e Brendshme paraqitet në nivele të kënaqshme, Komisioni gjykon se pr/buxheti për vitin 2019 për Ministrinë e Brendshme mbulon të gjitha nevojat e këtij institucioni mjaft të rëndësishëm për rendin dhe sigurinë publike, e për këtë arsye edhe për këtë ministri nuk ka vërejtje ose propozime konkrete në zërat buxhetorë.

Tre janë shtyllat kryesore që synohet të arrihen gjatë vitit buxhetor 2019:

1.Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe garantimi i sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, të cilat janë dhe prioritetet për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, e cila do të ketë si togfjalësh kyç në veprimtarinë e saj, ‘kontrollin e territorit’ dhe ‘policimin në komunitet’, të realizuara në praktikë përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor, në funksion të një kontrolli më efektiv të tij dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit.

2.Sigurimi i rendit publik, pronës publike e private, rritja e parametrave të sigurisë rrugore, krijimi i një mjedisi të sigurt për komunitetin, nëpërmjet shërbimeve profesionale, në kohë dhe me cilësi dhe policimit me standardet me të larta të performancës.

3.Përmirësimi i vazhdueshëm i Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësishme të Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standardet europiane në fushën e sigurisë

## **III. Shërbimi Informativ Shtetëror**

Buxheti i vitit 2019 për SHISH, në krahasim me vitet e mëparshme vlerësohet pozitiv dhe i përshtatshëm në përmbushjen e detyrave kryesore për këtë shërbim i cili ka një rol tepër të rëndësishëm për sigurinë kombëtare. Gjithsesi nevojat për t’iu përgjigjur sfidave të sigurisë paraqitet më e madhe për këtë shërbim dhe Komisioni mbështet kërkesat e këtij shërbimi për shtesë në numrin organik prej 85 punonjësish .Kjo rritje nuk ka kosto financiare shtesë në totalin e buxhetit pasi bëhet fjalë për shërbimin e sigurisë fizike e cila deri më sot është realizuar nga të tretë dhe me urdhrin e Kryeministrit nr.160, datë 29.10.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën dhe organikën e Shërbimit Informativ të Shtetit” është përfshirë në strukturën e brendshme të SHISH.

## **IV. Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile**

Gjatë dëgjësës së Drejtorisë së Përgjithshme e Emergjencave Civile në komision, u sugjerua që buxheti i kësaj drejtorie të ketë rritje në zërin e investimeve për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore pasi kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e cenueshmërisë së jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga emergjencat civile dhe në ofrimin e mbrojtjes civile për ta.

## **V. Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit**



Gjatë dëgjësës së Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit në komision, si dhe duke mbajtur në konsideratë funksionin dhe detyrat e saj në kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i cili kërkon një menaxhim më të mirë dhe të sigurtë dhe brenda standardeve shengen të BE-së, komisioni, sugjeron që kërkesa e Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit për integrimin e sistemit të radarëve për mbikëqyrjen e hapësirës detare të shihet me prioritet


## **VI. Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve.**

Buxheti i parashikuar për këtë Drejtori duhet të rikonsiderohet pasi paraqet nevoja për rritje në drejtim të mirëmbajtjes të Burgjeve të reja të ngritura sipas standardeve europiane. Rritja e buxhetit për Sistemin e Burgjeve mundëson funksionimin normal dhe ofron garanci se siguria në këtë sistem të rëndësishëm nuk cenohet, përkundrazi synohet të rritet dhe përmirësohet.

## **VII. Garda e Republikës**

Buxheti i parashikuar për këtë shërbim duhet të rikonsiderohet me qëllim rritje rritjen e pagave duke i njëhsuar me ato të punonjësve Policisë së Shtetit.

Kërkesa që Garda e Republikës ngri para Komisionit të Sigurisë Kombëtare për trajtimin ushqimor dhe të cilën ky komision e gjen me vend ta mbështesë, është që trajtimi ushqimor të përfshihet brenda tavaneve buxhetore të këtij institucioni.

 **KOMISIONI NË PËRFUNDIM TË DISKUTIMEVE**, me shumicë votash vendosi ta miratojë nen për nen dhe në tërësi pr/ligjin për buxhetin e vitit 2019 dhe t'ia përcjellë komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat dhe seancës plenare me këto sugjerime:

### **Për SHISH**

Këkohet një shtesë në organikë me 85 punonjës. Kjo rritje nuk ka kosto financiare shtesë në totalin e buxhetit, pasi bëhet fjalë për shërbimin e sigurisë fizike e cili deri më sot është realizuar nga të tretë dhe me urdhrin e Kryeministrit nr.160, datë 29.10.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën dhe organikën e Shërbimit Informativ të Shtetit” është përfshirë në strukturën e brendshme të SHISH.

Për këtë SHISH kërkon saktësimin e tavaneve buxhetore, duke pakësuar në shumën 58,000 mijë lekë shpenzimet për mallra dhe shërbime (art.602) dhe duke shtuar zërin paga dhe sigurime për personelin.

Komisioni mbështet kërkesën e SHISH për saktësimin e tavaneve buxhetore, duke pakësuar në shumën 58,000 mijë lekë shpenzimet për mallra dhe shërbime (art.602) dhe duke shtuar zërin paga dhe sigurime për personelin.

### **Për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve**

Komisioni mbështet kërkesën për shtesë fondi për këtë drejtori, si më poshtë:

- Shtesë prej 120 punonjësish, civilë dhe ushtarakë, për vënien në efikasitet të godinës së re të IEVP 313 “Jordan Misja”, investim i cili përfundon në fund të vitit 2018. Për vënien në funksionim të këtij institucioni të ri i cili do të lehtësojë ndjeshëm të

gjithë mbipopullimin në paraburgime, do të nevojitet fondi shtesë prej **36,000 mijë lekë**.

- Njehësimin e pagave të mjekëve te sistemit të burgjeve me ato të mjekëve të sistemit të përgjithëm shëndetësor, në kushtet kur sistemi mjek infermierë në burgje po paraqet gjithnjë e më shumë mungesa për shkak të pagave të ulëta. Fondi shtesë që nevojitet është **38,400 mijë lekë**.

### **Për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile**

Komisioni mbështet nevojën e kësaj drejtorie për shtesë fondi, në drejtim të mirëmbajtjes të Burgjeve të reja të ngritura sipas standardeve europiane

### **Për Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit.**

Komisioni mbështet dhe sugjeron shtesë fondi për Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit, në funksion të integritetit të sistemit të radarëve për mbikqyrjen e hapësirës detare, duke integruar në një sistem të vetëm ose në një administrim të vetëm si radarët e Policisë së Shtetit dhe ato që ka QNOD, ku përfitues të produktit janë dhe institucione të tjera qendrore, me një fond buxhetor prej 405 milion lekë.

### **Për Gardën e Republikës**

Komisioni mbështetet dhe sugjeron shtesë fondi për trajtimin financiar, trajtimin ushqimor të punonjësve të Gradës së Republikës si dhe mbështetjen me fondet e nevojshme për realizimin e investimeve në infrastrukturë për financimin e projekteve si : Rikonstruksion i plotë i ndërtesave dhe ambienteve të jashtme e të brendshme në Qendrën e Formimit dhe Kualifikimit Profesional, në Mullet, me vlerë projekti 250,000,000 lekë si dhe sistemim dhe asfaltim sheshi, rrugëve lidhëse dhe parkim mjetesh, me vlerë 10,000,000 lekë.

➤ Sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare pasi miratoi nen për nen dhe në tërësi pr/ligjin për buxhetin e vitit 2019 me sugjerimet përkatëse, vendosi dërgimin e këtij raporti Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe Seancës Plenare.

### **Relator**

Xhemal QEFALIA  
Pjerin NDREU  
Sadi VORPSI

### **Kryetar**

Ermonela (Felaj) VALIKAJ